



01 Nr. 543/24 Dt. 05.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, të nenit 8 dhe 16 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për ankesa

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj listës së përfituesve për dru të zjarrit për ngrohje të publikuara nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) për persona fizik për furnizim me dru për ngrohje për familjet skamnorë nga radhët e komunitetit minoritar në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - Arben Krasniqi,.....kryesues i komisionit,
 - Sezana Hameli,.....anëtare,
 - Senada Etemi,.....anëtare.
- Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me thirrjen publike për persona fizik për furnizim me dru për ngrohje për familjet skamnorë nga radhët e komunitetit minoritar në Komunën e Prizrenit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

